



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Punëve të Brendshme
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova / Ministry of Internal Affairs



Policia e Kosovës/Policija Kosova/Kosovo Police
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate
Drejtoria për Planifikim Strategjik dhe Çështje Lëgjore
Direktorat za Strateško Planiranje i Zakonska Pitanja/Directorate for Strategic Planning and Legal Issue
Sektori për Planifikim Strategjik / Sektor za Strateško Planiranje / Sector for Strategic Planning

POLICIMI NË KOHËN E PANDEMISË: RAPORTI GJASHTË (6) MUJOR I PUNËS SË POLICISË SË KOSOVËS



JANAR - QERSHOR
2020



Titulli i raportit: **Policimi në kohën e pandemisë:
Raporti gjashtë (6) muajor i punës së Policisë së Kosovës
Janar - Qershor 2020**

Përpiluesi: **Rreshter Fahrije LUTFIU**
Zyrtar për Planifikim Strategjik
Sektori për Planifikim Strategjik
Drejtoria për Planifikim Strategjik dhe Çështje Ligjore

Mbikëqyrur: **Major Sadik SHEFQETI**
Sektori për Planifikim Strategjik
Drejtoria për Planifikim Strategjik dhe Çështje Ligjore

Nënkolonel Nazmija BAŠOVIĆ
Shefi i Sektorit për Planifikim Strategjik
Drejtoria për Planifikim Strategjik dhe Çështje Ligjore

Aprovon: **Nënkolonel Çlirim HAJDINI**
Zëvendësues i Drejtorit të Drejtorisë për Planifikim Strategjik
dhe Çështje Ligjore

Autorizon: **z. Rashit QALAJ**
Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Republikës së Kosovës

Lektor: **znj. Leonora FEJZULLAHU - RUHANI**
Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë

Përkthim në gjuhën **Sektori i përkthimeve**
Angleze dhe Serbe: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë

Dizajni grafik: **z. Çajup KAJTAZI**
Webdizajner
Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë

Policia e Republikës së Kosovës
www.kosovopolic.com

☎ 192

✉ info@kosovopolic.com

POLICIMI NË KOHËN E PANDEMISË: RAPORTI GJASHTË (6) MUJOR I PUNËS SË POLICISË SË KOSOVËS



TABELA E PËRMBAJTJES

■ PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	4
■ PARANDALIMI I PËRHAPJES SË KORONAVIRUS COVID-19.....	6
■ SIGURIA, RENDI DHE QETËSIA PUBLIKE.....	9
■ SIGURIA NË TRAFIKUN RRUGOR.....	11
■ PARANDALIMI DHE LUFTIMI I KRIMIT TË ORGANIZUAR, KRIMET E RËNDA, ■ KRIMI EKONOMIK & KORRUPSIONI, TERRORIZMI, EKSTREMIZMI I DHUNSHËM DHE RADIKALIZMI.....	12
■ KONTROLLI, MBIKËQYRJA DHE MENAXHIMI I INTEGRUAR I KUFIRIT.....	14
■ NGRITJA E KAPACITETEVE NJERËZORE DHE MATERIALE.....	16
■ LISTA E SHKURTESAVE.....	20

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në Policinë e Kosovës janë të punësuar 9221 punonjës, prej të cilëve 8221 janë zyrtarë policorë, ndërsa 1000 staf civil. 84.95% e personelit të PK-së i takojnë gjinisë mashkullore, ndërsa 15.05% gjinisë femërore, prej të cilëve 84.58% i takojnë përkatësisë etnike shqiptare, ndërsa 15.42% i takojnë grupeve tjera etnike.

Numri i rasteve të raportuara ka shënuar rënie për 6.56%.

Numri i personave të arrestuar ka shënuar ngritje për 1.29%.

Aksidentet në trafikun rrugor kanë shënuar rënie për 13.68%

Persona të vdekur në aksidentet e trafikut rrugor kanë shënuar rënie për 34.1%

Numri i rasteve të dhunës në familje ka shënuar ngritje për 19.37%.

Me qëllim të parandalimit të përhapjes së koronavirusit brenda Policisë, përmes Drejtorisë së saj për Shërbime Shëndetësore (DShSh), janë: (a) organizuar ligjërata në temë se si të mbrohem nga koronavirusi; (b) vendosur 500 posterë "Jo frikë por kujdes të shtuar për COVID-19", si dhe (c) shpërndarë 1400 broshura "Korona virus dhe shëndeti mendor".

Në zbatimin e UO për Gatishmëri dhe reagim kundër coronavirus COVID-19 janë angazhuar gjithsejtë 6500 zyrtar policor apo 79.06% e personelit të uniformuar të PK-së, të cilët kanë qenë të angazhuar në:

(a) patrullimin parandalues 24/7 me 2 ndërrime, në orarin 12 orësh.

(b) ofrimin e sigurisë në Qendrën Studentore si karantinë e detyrueshme dhe Klinikën Infektive me prezencën e saj 24/7;

(c) 166 pika të kontrollit në hyrje/dalje të 63 zona komunale në karantinë;

(d) inspektimin e 10,671 qytetarëve të cilët gjinden në vetizolim në shtëpi;

(e) 1406 përcjellje policore;

(f) 1451 asistime inspektorëve komunal.

Polica e Kosovës ka hapur 1463 raste të mosveprimit sipas dispozitave shëndetësore gjatë epidemisë ndaj 2556 personave.

651 raste janë dërguar në Prokurori, ndërsa 812 raste kanë mbetur të hapur.

Për mosveprim sipas dispozitave shëndetësore gjatë epidemisë janë:

- arrestuar 1094 persona,
- ndaluar 231 persona, dhe
- shqiptuar 20,493 vërejtjet.

Gjatë kësaj periudhe raportuese janë dezinfektuar 118 objekte policore dhe shpërndarë: 18,591 maskë mbrojtëse kundër virusit; 18,000 dorëza mbrojtëse kundër virusit; 170 veshje mbrojtëse kundër virusit; 137 litra alkool 70% dhe 395 dezinfektues tjerë.

Përkundër angazhimit të madh në parandalimin e përhapjes së koronavirusin në polici, brenda kësaj periudhe raportuese janë infektuar 89 zyrtarët policor me virusin COVID-19, 759 punonjës të PK-së kanë qenë në vetizolim, ndërsa nga ana e personelit të Drejtorisë së Shërbimeve Shëndetësore pranë PK-së, janë bërë 365 gjurmime epidemiologjike brenda PK-së. Deri me datën 08.07.2020, janë të shëruar 34 punonjës të PK-së nga COVID-19, ndërsa 55 raste janë ende aktiv me COVID-19.

Njësitet e specializuara për operacione policore, kanë pasur ngritjen e angazhimeve, ku numri i (a) patrullimeve, ka shënuar ngritje, nga 179 në 760, ose ngritje për 324.58%; (b) pikave të kontrollit, ka shënuar ngritje, nga 367 në 526, ose ngritje për 43.32%; (c) asistimeve të njëjive të ndryshme policore, poashtu ka shënuar ngritje nga 217 në 414, ose ngritje për 90.78%.

Me qëllim të ofrimit të sigurisë së kufijve, janë ndërmarrë: 94 operacione, 69 patrullime të përbashkëta, realizuar 33 raste të bashkëpunimit ndërkombëtar, 854 refuzime të hyrjes dhe 216 refuzime të daljes nga RKS, shqiptuar 212 gjoba në fushën e qëndrimit ilegal dhe mosvazhdimin e lejes së qëndrimit.

Policia e Kosovës ka identifikuar 422 punonjës të saj, të cilët kanë sëmundje me risk të lartë ndaj koronavirusit dhe të cilët janë liruar nga ardhja në punë dhe rekomanduar qëndrimi në shtëpi.

Policia e Kosovës, përmes DShSh-së, ka ofruar në vazhdimësi përkrahje të nevojshme këtyre zyrtarëve.



Raste	
Viti 2019	Viti 2020
20,014	18,472



Vepra penale	
Viti 2019	Viti 2020
14,691	13,310



Persona të arrestuar	
Viti 2019	Viti 2020
6,731	6,818



Persona të ndaluar	
Viti 2019	Viti 2020
1,955	2,291



Grupe kriminale të goditura	
Viti 2019	Viti 2020
19	8



Armë zjarri të konfiskuara	
Viti 2019	Viti 2020
705	480



Municione të konfiskuara	
Viti 2019	Viti 2020
7,512	6,155



Persona të vdekur në trafikun rrugor	
Viti 2019	Viti 2020
44	29



Tiketa të shqiptuara në trafikun rrugor	
Viti 2019	Viti 2020
200,906	170,418

Gjopa për kundërvajtjeve në fushën e migrimit	
Viti 2019	Viti 2020
705	212



Aksidente në trafikun rrugor	
Viti 2019	Viti 2020
6,495	5,602



Hyrje/dalje të personave në kufi	
Viti 2019	Viti 2020
7,576,285	3,875,991



Protesta dhe tubime të qytetarëve	
Viti 2019	Viti 2020
200	92



Refuzimi i hyrjes në RKS	
Viti 2019	Viti 2020
697	854

Refuzimi i daljes nga RKS	
Viti 2019	Viti 2020
486	216

PARANDALIMI I PËRHAPJES SË KORONAVIRUSIT COVID-19

Me qëllim të parandalimit të përhapjes së Koronavirusit COVID-19, në përputhje me planin e Ministrisë së Shëndetësisë (MSh) për gatishmëri dhe reagim kundër Koronavirusit COVID-19, me datën 12.03.2020, Policia e Kosovës (PK) ka hartuar UO për Gatishmëri dhe reagim kundër Coronavirus COVID-19, i cili ka për qëllim:

- bashkëpunimin dhe koordinimin e aktiviteteve me institucionet qendrore dhe lokale, përgjegjëse për parandalimin dhe luftimin e rreziqeve nga koronavirusi;
- përgatitja paraprake e planeve operative policore për përballje me mjediset epidemiologjike;
- krijimi dhe zhvillimi i kontakteve, bashkëpunimi dhe harmonizimi i veprimeve të përbashkëta me institucionet shëndetësore, agjencitë dhe institucionet tjera reaguese në parandalimin dhe luftimin e koronavirusit;
- Ofrimin e mbështetjes në aspektin e sigurisë së agjencive & institucioneve tjera shëndetësore dhe emergjente;
- Ngritja e vigjilencës policore për reagim të sigurt dhe efikas, gjithmonë duke i ndërmarr masat fillimisht për siguri personale dhe të tjerëve.



Si masë e parandalimit të përhapjes së koronavirusit në Kosovë, me datën 15 mars 2020, me vendimin e Qeverisë së Kosovës Nr.01/11, është shpallur emergjencë për shëndetin publik dhe me të njëjtin vendim, janë obliguar Institucionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës të veprojnë konform planit të reagimit kombëtar dhe të aktivizohet funksioni mbështetës emergjent 8 (FME8 shëndeti publik dhe shërbimet mjekësore).

Pas shpalljes së emergjencës për shëndetin publik, me datën 18 mars 2020, me vendimin e Qeverisë së Kosovës Nr.01/13, Qendra Studen-



tore në Prishtinë ka kaluar në menaxhimin e drejtpërdrejtë të Ministrisë së Shëndetësisë. Me këtë vendim, çdo person i cili vërtetohet ose dyshohet se ka qenë në kontakt drejtpërdrejt me personin e sëmurë apo të dyshuar në sëmundje nga Koronavirus COVID-19, do të vendosen në karantinë. Për të siguruar qëndrueshmërinë e funksionimit të karantinës së detyrueshme, Ministria e Shëndetësisë ka qenë e mbështetur nga: vullnetarët, personeli i Qendrës Studentore (QS) dhe PK-së, e cila ka qenë autoriteti përgjegjës për ofrimin e sigurisë 24 orë të QS si karantinë e detyrueshme me 108 zyrtarë policorë, me 14 pika statike, pasi që QS përbëhet nga 8 konvikte. Përveç ofrimit të sigurisë së QS si karantinë e detyrueshme, Policia e Kosovës ka fuqizuar gjithashtu prezencën e saj në Qendrën e Klinikës Universitare të Kosovës, në theks ofrimin e sigurisë së Klinikës Infektivës me prezencën e saj 24/7.

Si rezultat i zhvillimeve në terren, me datën 19 mars 2020 u.d i ministrit të Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike, ka marrë vendim për aktivizimin e Planit për reagimin kombëtar, me ç'rast është themeluar Grupi Ndërinstitucional për Menaxhimin e Incidenteve (GNMI), në përbërjen e gjerë të autoriteteve të sistemit të sigurisë së Kosovës, duke përfshirë edhe PK-në, koordinatori i të cilit është u.d i ministrit të Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike.

Me aktivizimin e planit për reagim kombëtar, është mobilizuar PK-ja në parandalimin e përhapjes së Koronavirusit COVID-19 dhe njëkohësisht në vazhdimin e përmbushjes së të gjitha detyrave policore të parapara me Ligjin e policisë, planin zhvillimor strategjik 2016-2020 të PK-së dhe planin e punës së PK-së për vitin 2020, por tani në rrethana të reja, duke vepruar në mjediset epidemiologjike.

Për të siguruar koordinimin e aktiviteteve ndërinstitucionale në parandalimin e përhapjes së koronavirusit në Kosovë dhe njëkohësisht



për të parandaluar përhapjen e virusit brenda Policisë, Policia e Kosovës ka aktivizuar Qendrën Komanduese për Menaxhim të Operacionit në nivel të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë (DPP) dhe në nivelin e Drejtorive Rajonale të Policisë (DRP), dhe njëkohësisht ka dërguar përfaqësuesin në:

- Komitetin për koordinim dhe vlerësim të situatës emergjente me Koronavirus COVID-19, i themeluar nga Ministria e Shëndetësisë, si dhe në

- Qendrën Operative të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Në zbatimin e UO për Gatishmëri dhe reagim kundër Koronavirus COVID-19 janë angazhuar gjithsejtë 6500 zyrtarë policorë apo 79.06% e personelit të uniformuar të PK-së, të cilët kanë qenë të angazhuar në: (a) patrullimin parandalues 24/7 me 2 ndërrime, në orarin 12 orësh; (b) ofrimin e sigurisë së QS si karantinë e detyrueshme dhe Klinikën Infektive; (c) 166 pika të kontrollit në hyrje/dalje të 63 zona komunale në karantinë; (d) inspektimin e 10,671 qytetarëve të cilët gjenden në vetizolim në shtëpi; (e) 1406 përcjellje policore, si dhe (f) 1451 asistime inspektorëve komunalë.

Gjatë kësaj periudhe raportuese në kuadër të aktiviteteve policore të orientuara në zbatimin e UO janë hapur 1463 raste të mosveprimit sipas dispozitave shëndetësore gjatë epidemisë ndaj 2556 personave, prej të cilëve 651 raste janë

dërguar në Prokurori, ndërsa 812 raste kanë mbetur të hapura. Brenda kësaj periudhe, për mosveprim sipas dispozitave shëndetësore gjatë epidemisë janë arrestuar 1094 persona, janë ndaluar 231 persona dhe janë shqiptuar 20,493 vërejtje.

Me qëllim të parandalimit të përhapjes së koronavirusit brenda Policisë, PK-ja përmes Drejtorisë së saj për Shërbime Shëndetësore gjatë muajit shkurt 2020 ka zhvilluar një numër të madh të aktiviteteve para shpalljes së gjendjes emergjente për shëndetin publik, duke filluar me:

- mbajtjen e ligjëratës me temën se si të mbrohem nga koronavirusi
- vendosjen e 500 posterëve “Jo frikë por kujdes të shtuar për COVID-19”
- shpërndarjen e 1400 broshurave “Korona-virusi dhe shëndeti mendor”

Po ashtu, janë identifikuar 422 zyrtarë të PK-së, të cilët kanë sëmundje me risk të lartë ndaj

koronavirusit, të cilët janë liruar nga ardhja në punë dhe është rekomanduar qëndrimi në shtëpi. Gjatë kësaj periudhe raportuese janë dezinfektuar 118 objekte policore dhe janë shpërndarë: 18,591 maska mbrojtëse kundër virusit; 18,000 dorëza mbrojtëse kundër virusit; 170 veshje mbrojtëse kundër virusit; 137 litra alkool 70% dhe 395 dezinfektues tjerë.

Përkundër angazhimit të madh në parandalimin e përhapjes së koronavirusin në polici, brenda kësaj periudhe raportuese janë infektuar 89 zyrtarë policorë me virusin COVID-19, 809 punonjës të PK-së kanë qenë në vetizolim, ndërsa nga ana e personelit të Drejtorisë së Shërbimeve Shëndetësore pranë PK-së, janë bërë 365 gjurmime epidemiologjike brenda PK-së. Deri me datën 08 korrik 2020, janë të shëruar 50 zyrtarë të PK-së nga COVID-19, ndërsa 56 raste të zyrtarëve të PK-së janë ende aktive me COVID-19.



SIGURIA, RENDI DHE QETËSIA PUBLIKE

Me anë të një bashkëpunimi të ngushtë me qytetarët por edhe me të gjitha institucionet vendore dhe ndërkombëtare relevante në fushën e sigurisë, Policia e Kosovës ka arritur rezultate të konsiderueshme në luftimin e dukurive më shqetësuese të shoqërisë, përkundër sfidave të shumta të cilat janë paraqitur gjatë përmbushjeve të objektivave policore, si rezultat i shpalljes së gjendjes emergjente për shëndetin publik në Kosovë.

Gjatë periudhës raportuese, Policia e Kosovës ka evidentuar gjithsej 18,472 raste, prej të cilave 13,310 janë klasifikuar si vepra penale, ndërsa 5,162 raste janë klasifikuar si kundërvajtje dhe raste të natyrave të tjera. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019, numri i rasteve ka shënuar rënie për 6.56%, numri i veprave penale po ashtu ka shënuar rënie për 9.40%. Rënie/ngritje më të dalluara janë vërejtur si në vijim:

- Numri i vrasjeve, ka shënuar rënie, nga 13 në 11 ose rënie për 15.38%;
- Numri i lëndimeve të rënda trupore ka shënuar rënie, nga 128 në 118, ose rënie për 7.81%;
- Numri i vjedhjeve ka shënuar rënie, nga 2,275, në 1,792, ose rënie për 21.23%;
- Numri i vjedhjeve të rënda ka shënuar rënie, nga 2077 në 1730, ose rënie për 16.70%;
- Numri i grabitjeve po ashtu ka shënuar rënie, nga 17 në 12, ose rënie për 29.41%;
- Numri i rasteve të dhunës në familje ka shënuar ngritje, nga 836 në 998, ose ngritje për 19.37%.



Policia e Kosovës ka ndaluar 2,291 persona për shkak të dyshimeve në përfshirje në akte kriminale, ku në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2019 është shënuar një ngritje për 17.18%. Po ashtu, Policia ka arrestuar 6,818 persona të cilët në bashkëpunim me autoritetet përkatëse janë dërguar në procedura të mëtejme. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak, vërehet një ngritje e personave të arrestuar për 1.29%.

Në operacione të ndryshme të ndërmarra, policia ka konfiskuar 490 armë zjarri të llojeve të ndryshme dhe në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2019 është shënuar një rënie për 30.49%, si dhe ka konfiskuar 6,155 sasi të municionit të kalibrave të ndryshëm dhe në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2019 është shënuar një rënie për 18.06%.

Gjatë kësaj periudhe, Policia ka regjistruar gjithsej 92 protesta dhe tubime, në të cilat Policia e Kosovës ka kryer një varg të detyrave policore lidhur me këto protesta dhe tubime. Në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2019 vërehet një ulje e protestave dhe tubimeve për 54%.





Në fushën e aktiviteteve të njësive të specializuara për operacione policore, gjatë kësaj periudhe këto njësite kanë pasur ngritje të angazhimeve të tyre në të gjitha fushat e angazhimit, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019. Saktësisht,

- Numri i patrullimeve ka shënuar ngritje, nga 179 në 760, ose ngritje për 324.58%;
- Numri i pikave të kontrollit ka shënuar ngritje, nga 367 në 526, ose ngritje për 43.32%;
- Numri i asistimeve të njësive të ndryshme policore, po ashtu ka shënuar ngritje nga 217 në 414, ose ngritje për 90.78%.

Përveç angazhimit në parandalimin e përhapjes së koronavirusit në Republikën e Kosovës dhe vazhdimin e përmbushjes së të gjitha detyrave policore të parapara me Ligjin e policisë dhe planin e punës së PK-së për vitin 2020, Policia ka vazhduar të ofrojë sigur 24 orëshe në 123 pika statike të objekteve të rëndësisë së veçantë: diplomatike, qeveritare, policore, ministore, prej të cilave 24 pika statike të objekteve të trashëgimisë kulturore dhe fetare ortodokse. Ndërsa për të gjitha objektet tjera të rëndësisë së veçantë, Policia e Kosovës kujdeset me anë të patrullimeve të rregullta, ku në bazë të vlerësimeve ndërmerret edhe aktivitete tjera të nevojshme për sigurinë e këtyre objekteve.



SIGURIA NË TRAFIKUN RRUGOR

Siguria në trafikun rrugor vazhdon të mbetet sfidë jo vetëm për Kosovën, por edhe për shume shtete të Evropës dhe të botës. Për të adresuar këtë sfidë, Policia e Kosovës në vazhdimësi po bën përpjekje të mëdha që të ngrihet siguria në trafikun rrugor duke përdorur një qasje të ofrimit të sigurisë e cila në bërthamën e saj ka: (i) parandalimin (me metodat proaktive dhe reaktive) dhe zbulimin e të gjitha aktiviteteve që mund të ndikojnë negativisht në sigurinë e përgjithshme të trafikut rrugor, (ii) bashkërendimin dhe koordinimin e veprimeve policore, me theks të veçantë ndërmjet njësive organizative të PK-së, pastaj ato ndërinstitucionale, ndërkombëtare, shoqërisë civile si dhe ekspertëve të ndryshëm të fushës së sigurisë në trafikun rrugor në kuptimin e saj më të gjerë, e cila në bërthamën e saj gjithashtu ka edhe (iii) orientimin strategjik të adresimit të sfidave në trafikun rrugor.

Për të adresuar sfidat në trafikun rrugor, Policia e Kosovës ka hartuar dhe ka zbatuar planin operativ në lidhje me ofrimin e sigurisë në trafikun rrugor, dhe si rezultat i këtyre përpjekjeve, ka shqiptuar 170,418 tiketa për kundërvajtje në trafikun rrugor dhe njëkohësisht ka arritur që të zvogëlojë numrin e aksidenteve në trafikun rrugor dhe numrin e personave të vdekur dhe të lënduar në aksidente rrugore.



Brenda kësaj periudhe vërehet një rënie e numrit të:

- aksidenteve në trafikun rrugor, nga 6,495 në 5,602 aksidente, apo rënie për 13.75%;
- aksidenteve me fatalitet, nga 38 në 27 aksidente, apo rënie për 28.94%;
- aksidenteve me lëndime, nga 2,452 në 2,118 aksidente, apo rënie për 13.62%;
- aksidenteve me dëme materiale, nga 4,005 në 3,457 aksidente, apo rënie për 13.68%;

Fatkeqësisht, edhe përkundër përpjekjeve të mëdha të Policisë, gjatë kësaj periudhe:

- 29 persona kanë humbur jetën, që në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2019 shënon rënie për 34.1%.
- 3,931 persona janë lënduar, që në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2019 shënon rënie për 15.59%.

Në kuadër të angazhimeve në ngritjen e sigurisë në trafikun rrugor, gjatë kësaj periudhe janë realizuar 247 përcjellje të materieve të rrezikshme dhe 94 përcjellje të personaliteteve të rëndësishme. Po ashtu, në përputhje me UO për Gatishmëri dhe reagim kundër Coronavirus COVID-19, Polica ka realizuar 1406 përcjellje të ndryshme policore.



PARANDALIMI DHE LUFTIMI I KRIMIT TË ORGANIZUAR, KRIMET E RËNDA, KRIMI EKONOMIK & KORRUPSIONI, TERRORIZMI, EKSTREMIZMI I DHUNSHËM DHE RADIKALIZMI

Gjatë kësaj periudhe raportuese, në kuadër të aktiviteteve policore të orientuara në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar, krimet e rënda, krimit ekonomik & korrupsionit, terrorizmit, ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit, janë realizuar 277 operacione, 394 bastisje dhe lokale të kontrolluara. Brenda kësaj periudhe, janë punuar në gjithsej 922 raste, prej tyre 474 raste të reja, 240 raste të pranuar nga njësitë tjera në kuadër të Policisë së Kosovës, 205 raste janë bartur nga vitet paraprake, ndërsa 3 raste janë transferuar në njësi tjera. Janë ngritur 499 kallëzime penale, 30 prej të cilave me kryes të panjohur, 469 kallëzime penale me kryes të njohur ndaj 706 personave, ndërsa 47 raste janë dërguar në prokurori me raport të veçantë. Brenda kësaj periudhe raportuese, janë arrestuar 724 persona të dyshuar për vepra të rënda penale, janë ndaluar 196 persona dhe janë goditur 8 grupe kriminale.

Në fushën e luftimit të trafikimit me qenie njerëzore, gjatë kësaj periudhe janë punuar në 44 raste, prej tyre 27 raste kanë qenë të reja. Janë realizuar 05 plane operative, 14 operacione, janë arrestuar 40 persona të

dyshuar, janë ngritur 14 kallëzime penale, 06 raste janë dorëzuar në prokurori me raport të veçantë, 9 raste janë dorëzuar në gjykatë-divizioni për kundërvajtje, ndërsa për 15 raste vazhdojnë hetimet. Brenda kësaj periudhe janë identifikuar 3 viktima të trafikimit, ku prej tyre 2 janë asistuar duke u strehuar në strehimoret përkatëse për riintegrim dhe rehabilitim, 2 viktima tjera janë kthyer në vendin e origjinës në Malin e Zi në mënyrë të asistuar sipas protokolleve të bashkëpunimit, ndërsa të tjerat janë kthyer në familje. Gjithashtu janë trajtuar edhe 10 viktima potenciale, (08 janë viktima të veprave tjera penale, ndërsa ndaj 02 nuk ka rezultuar me rast)

Në fushën e parandalimit, hetimit dhe zbulimit të trafikimit me narkotikë është punuar në 649 raste, prej tyre 276 raste kanë qenë të reja. Janë realizuar 18 plane operative dhe 274 operacione. Janë neutralizuar 3 grupe kriminale, janë arrestuar 612 persona, janë ngritur 381 kallëzime penale ndaj 490 personave. Janë konfiskuar: 2 kg 119 g heroinë; 285.88 gr kokainë; 12.6 gr ekstazi; 109 kg 739 gr. marihuanë, 1753 bimë kanabis.



Në fushën e luftimit kundër krimeve ekonomike, korrupsionit dhe pasurisë janë hetuar 126 raste, janë ngritur 68 kallëzime, janë arrestuar 48 persona të dyshuar, janë realizuar 14 operacione dhe 9 plane operative, si dhe janë neutralizuar 6 grupe të organizuara kriminale.

Si rezultat i angazhimit dhe zbatimit të ligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale, janë ngrirë, sekuestruar/konfiskuar përkohësisht: 1 shtëpi, 1 banesë, 40 parcela tokë dhe 7 vetura.

Në fushën e hetimit të krimeve të rënda, gjatë kësaj periudhe janë trajtuar 46 raste, prej të cilave 34 raste të reja, 13 raste janë pranuar nga njësi tjera, 12 janë trajtuar nga vitet e më hershme. Janë realizuar 3 operacione dhe 3 bastisje në lokacione, janë arrestuar 5 persona dhe janë ngritur 15 kallëzime penale. Brenda kësaj periudhe janë pranuar 13 autorizime për krime lufte, janë hulumtuar 8 vend-lokacione për gjetje eshtërore.

Parandalimi dhe luftimi i terrorizmit, ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit - luftës kundër këtij fenomeni, Policia e Kosovës i është qasur në mënyrë strategjike, duke filluar prej bashkëpunimit në nivel lokal përmes Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi (KKSB), Këshillave Lokale për Siguri në Publike (KLSP), e deri te hartimi dhe implementimi i Strategjisë Kombëtare të Republikës së Kosovës Kundër Terrorizmit, si dhe Strategjinë



për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit që shpie në terrorizëm, Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare.

Gjatë periudhës së gjashtëmujorit të parë 2020, autoritetet e specializuara për parandalimin dhe luftimin e terrorizmit në kuadër të Policisë së Kosovës kanë trajtuar gjithsej 30 raste të bartura nga vitet e kaluara. Në vazhdimësi bëhet rifreskimi i të dhënave të personave të cilët dyshohet se kanë qenë, janë apo planifikojnë të shkojnë t'iu bashkëngjiten organizatave terroriste. Policia vazhdon me patrullimet në rrjetin e internetit për të identifikuar persona me interes të Policisë, komunikata të lëshuara nga persona që përkrahin organizata të ndryshme terroriste, kërcënime të personave të ndryshëm duke u thirrur në aspektin e nxitjes së terrorizmit.



KONTROLLI, MBIKËQYRJA DHE MENAXHIMI I INTEGRUAR I KUFIRIT

Policia e Kosovës ka treguar një përkushtim të veçantë edhe në fushën e kontrollit dhe mbikëqyrjes së kufirit, kontrollit të qëndrimit dhe lëvizjes së të huajve, luftimin e krimit ndërkufitar, si dhe avancimin e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për Menaxhimin e Integruar të Kufijve (MIK).

Si rezultat i bashkëpunimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve autoriteteve të MIK-ut, kufijtë e Republikës së Kosovës i kanë kaluar: 3,875,991 persona, që krahasuar me vitin e kaluar tregojnë rënie për 48.84%; 1,533,674 mjetet motorike, që tregojnë rënie për 42.22% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, si dhe 305 trena, që krahasuar me vitin e kaluar gjithashtu tregojnë rënie për 57.10%.

Në kuadër të kontrollit të hyrje-daljeve të personave në pikat kufitare janë evidentuar dhe janë procesuar 778 persona të rëndësishëm.



Sa i përket kontrollit të vijës së dytë, pjesëtarët e Policisë së Kosovës, në përputhje me parimet e MIK-ut, kanë arritur që të kontrollojnë:

Tabela nr.1: Kontrolli i vijës së dytë.

Kategoritë	Janar- Qershor 2019	Janar- Qershor 2020	%
Persona	33,321	16,637	-50
Automjete	15,057	7,582	-49
Dokumente	8,517	3,216	-62

Gjatë ofrimit të sigurisë së kufijve të Republikës së Kosovës, si rezultat i shkeljeve të ndryshme ligjore, pjesëtarët e Policisë së Kosovës kanë hapur 258 raste të veprave penale, 161 kundërvajtje, kanë shqiptuar 212 gjopa për kundërvajtje në fushën e migrimit dhe të huajve. Policia kufitare ka arrestuar: (a) 344 persona për vepra të ndryshme kriminale; (b) 266 persona me urdhëresa vendore; (c) 2 persona me urdhëresa të ndryshme (ndërkombëtare etj.) dhe ka ndaluar 50 persona.



Me qëllim të përmbushjes së objektivave të parapara për periudhën raportuese, zyrtarët e Policisë Kufitare kanë bërë 326 inspektime në fushën e migrimit të huajve, 854 refuzime të hyrjes, 216 refuzime të daljes, si dhe kanë realizuar 238 verifikime të kërkesave për viza të Republikës së Kosovës. Po ashtu, zyrtarët e Policisë Kufitare kanë ekzekutuar 21 depërtime, 37 urdhër largime me forcë dhe kanë trajtuar dhe 781 kërkesa për azilkërkues.

Policia Kufitare gjatë kësaj periudhe ka realizuar 94 operacione dhe 69 patrullime të përbashkëta me shtetet fqinje (Shqipëri, Maqedoni dhe Mali i Zi). Sa i përket menaxhimit të integruar të kufirit janë realizuar: 36 takime të punës brenda Policisë, 79 takime me autoritetet e MIK-ut, ndërsa 33 aktivitete kanë qenë me karakter ndërkombëtar.



NGRITJA E KAPACITETEVE NJERËZORE DHE MATERIALE

Policia e Kosovës është themeluar me 6 shtator 1999, në atë kohë përbëhej nga 176 pjesëtarë të saj, tani përbëhet nga 9221 punonjës, prej të cilëve 8221 janë zyrtarë policorë, ndërsa 1000 staf civil. Nga ky numër 84.95% e personelit të PK-së i takojnë gjinisë mashkullore, ndërsa 15.05% gjinisë femërore, prej të cilëve 84.58% i takojnë përkatësisë etnike shqiptare, ndërsa 15.42% iu takojnë grupeve tjera etnike.

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e kontinuitetit të saj, Policia e Kosovës në vazhdimësi investon në kuadrat e saj, duke filluar me rekrutimin e gjeneratave të reja të policëve, ofrimin e njohurive bashkëkohore në fushën e zbatimit të ligjit, ngritjen e sistemeve të bazës së të dhënave të nevojshme për kryerjen sa më efektive dhe efikase të punës policore, furnizimin me të gjitha pajisjet e nevojshme për kryerjen e detyrave policore, renovimin/sanimin dhe rregullimin e infrastrukturës së objekteve të PK-së, si dhe ngritjen e shëndetit dhe mirëqenies së zyrtarëve të saj.

Për të përmbushur të gjitha këto obligime me sukses, Policia e Kosovës, për vitin 2020, ka në dispozicion buxhetin prej 96,701,309.00€. Brenda kësaj periudhe ka iniciuar 38 projekte të prokurimit dhe 283 urdhërblerja. Prej 38 projekteve të prokurimit të iniciuara,

29 kanë qenë për furnizim, 7 për shërbim, ndërsa 2 për punë. Ndërsa nga gjithsejtë 283 urdhërblerja, 169 kanë qenë për furnizim, 110 për shërbim, ndërsa 4 për punë. Për shkak të rritjes së angazhimit të policisë në planin operativ për gatishmëri dhe reagim kundër Koronavirus COVID-19, brenda kësaj periudhe është vërejtur ngritja e harxhimit të derivateve për vetura për 14.44%, krahasuar me periudhën e njëjtë vitit 2019.

Një nga drejtimet e rëndësishme për rritjen e aftësive dhe kapaciteteve profesionale të PK-së ka qenë dhe mbetet prioritet trajnimi dhe shkollimi i punonjësve të Policisë, por fatkeqësisht për shkak të situatës pandemike në Kosovë, këto trajnime që nga muaji mars 2020 janë të kufizuara. Si rezultat, gjatë kësaj periudhe raportuese, Policia e Kosovës ka organizuar 136 trajnime, ku në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2019 është shënuar një ulje për 72.69%. Këto trajnime i kanë vijuar 1890 pjesëmarrës, ku në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2019 është shënuar një ulje për 73.54%.

Policia e Kosovës, përmes aktiviteteve të Shoqatës së Grave të Policisë së Kosovës në vazhdimësi promovon vlerat e Policisë së Kosovës në ngjarje të ndryshme organizuar në nivel vendor dhe ndërkom-



bëtar, me qëllim të ngritjes së bashkëpunimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve në adresimin e sfidave policore. Gjatë kësaj periudhe, Policia e Kosovës, përmes Shoqatës së Grave të Policisë së Kosovës, ka qenë nikoqir i konferencës ndërkombëtare disa ditore (07-10 mars 2020) e mbajtur në Kosovë, ku ka pritur bordin e drejtorëve të Asociacionit Ndërkombëtar të Grave Police (IAWP).

Takimi i këtij niveli është mbajtur për herë të parë në rajonin e Ballkanit në 105 vjet histori të kësaj shoqate policore prestigjioze që ka shtrirje në gjithë botën. Në agjendën e saj disa ditore ka paraparë zhvillimin e punimeve në panele të ndryshme, ku panelistë kanë qenë: (a) ish presidentja e Republikës së Kosovës; (b) Ministri i Punëve të Brendshme; (c) drejtori i Përgjithshëm i PK-së; (d) zëvendës ambasadori amerikan; (e) shefja e Zyrës së BE-së; (f) menaxherja e Programit në ICITAP; (g) Avokati i Popullit; (h) përfaqësues nga misioni i OSBE-së në Kosovë, (i) kryetarët e shoqatës së PK-së dhe IAWP-së, (j) deputet të RKS-së; (k) përfaqësues nga zyra për barazi gjinore e kryeministrit, si dhe (l) përfaqësues të ndryshëm të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare .

Në këtë konferencë përveç tjerash nga ekspertë të fushave të ndryshme vendore edhe ndërkombëtare u diskutuan tema të ndryshme në fushën e rolit të femrave në ofrimin e sigurisë, sfidat në rekrutimin e femrave në institucione të sigurisë dhe barrierat për avancimin e tyre, kuptimi i policimit të bazuar në gjini si mundësi për zhvillimin e përgjegjshmërisë gjinore në polici, qasja policore e përqendruar tek viktimat gjatë proceseve si dhe menaxhimi i rasteve, rastet e dhunës në familje, trafikimi me qenie njerëzore, dhuna dhe abuzimi lidhur me teknologjinë dhe radikalizmin e dhunshëm si dhe tema të ndryshme.

Si rezultat i një analize për nevojën për plotësimin e strukturës komanduese me stafin e ri, brenda kësaj periudhe është organizuar test me shkrim për gradën toger, i cili është zhvilluar përmes nënmodulit të gradimit në sistemin e bazës së të dhënave PRIMs. Poashtu, është përpiluar lista e zyrtarëve policorë të cilët plotësojnë njëzet (20) vjet shërbim në Policinë e Kosovës, për të filluar me procedurat për ndarjen e “Medaljes për Shërbim të Besnikërisë”. Brenda kësaj periudhe janë shpallur 38 konkurse të brendshme dhe 1 i jashtëm.



Për të siguruar një qasje profesionale në zbatim të ligjit, Policia e Kosovës monitoron, kontrollon dhe heton veprimet e zyrtarëve të saj. Si rezultat i kësaj kontrole të brendshme gjatë kësaj periudhe Drejtoria për Hetime të Brendshme dhe Verifikim të së Kaluarës (DHBVK) ka trajtuar 300 lëndë për hetime të brendshme: 175 lëndë kanë qenë të iniciuara nga qytetarët, ndërsa 125 kanë qenë të iniciuara nga vet PK-ja. Gjatë kësaj periudhe, 113 raste kanë qenë të bazuara, 118 raste të pabazuara dhe të pa argumentuara, 4 raste janë rekomanduar në nivel lokal të adresimit, 3 lëndë janë kthyer në IPK, 30 raste janë në proces, kurse ndaj 32 rasteve janë pushuar hetimet.

Në Komisionin e Brendshëm Disiplinor (KBD) janë pranuar 98 lëndë nga Drejtoria për Hetime të Brendshme dhe Verifikim të së Kaluarës, janë shqyrtuar 78 lëndë, si dhe në proces janë 77 lëndë.

Nga gjithsejtë 130 raste të cilat ka pranuar dhe 37 raste kanë qenë të bartura, Komisioni i Ankesave (KA) ka shqyrtuar 141 raste, prej të cilave: në 82 raste është konstatuar se ankesa ka qenë e pa bazuar dhe vendimi mbetet në fuqi; në 07 raste ankesa ka qenë e bazuar dhe e aprovuar; në 18 raste ankesa ka qenë pjesërisht e bazuar dhe vendimi ka qenë pjesërisht i ndryshuar; në 31 raste vendimi është kthyer në plotësim të hetimeve, ndërsa në 03 raste ankesa është hedhur poshtë sepse është parashtruar jashtë afatit, është tërhequr nga ankuesi, i pa bazuar apo ankesa nuk ka përmbajtur arsye të mjaftueshme.

Kontrolli i brendshëm i Policisë është fuqizuar edhe me auditimet dhe inspektimet e brendshme. Si rezultat i kësaj kontrole, gjatë periudhës raportuese, Zyra e Auditimit në kuadër të PK-së ka realizuar 2 auditime të rregullta për të cilat janë dhënë 11 rekoman-

dime. Këto auditime janë bërë në fusha të ndryshme të zbatimit të ligjeve dhe akteve nënligjore që lidhen me fushën e prokurimit, financave dhe menaxhimit të pasurisë, si dhe në fushën e zbatimit të procedurave administrative për personelin e PK-së.

Gjithashtu në kuadër të inspektimeve të brendshme PK-ja ka realizuar 41 inspektime të rregullta si dhe 12 inspektime të jashtëzakonshme në të gjitha fushat e inspektimit të punës së policisë. Për të gjeturat e këtyre inspektimeve janë dhënë 75 rekomandime.

Në vazhden e aktiviteteve të zhvillimit strategjik të PK-së gjatë kësaj periudhe:

(a) ka filluar procesi i vlerësimit të realizimit të objektivave të parapara me planin zhvillimor strategjik të PK-së 2016-2020;

(b) është themeluar grupi punues për hartimin e planit strategjik zhvillimor të PK-së 2021-2025;

(c) Projekt ndryshim-plotësimi i Ligjit nr.03/L-118 për Tubime Publike është në proces të finalizimit, me ç'rast është përgatitur shkresa për dërgimin e këtij drafti për komente në Komisionin e Venecias;

(d) ka përfunduar faza e konsultimit paraprak të projekt ligjit për pensionimin e zyrtarëve policor (në pritje të hartimit të kostos buxhetore);

(e) projekt ndryshim-plotësimi i UA nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës është në

fazën e hartimit të draftit final;

(f) është hartuar drafti i parë i projektit UA për Përdorimin e Kamerave të Vëzhgimit në vendet publike;

(g) është hartuar drafti strategjia e integruar e policimit të drejtuar nga inteligjenca dhe policimi në bashkësi;

(h) është themeluar grupi punues për hartimin e rregullores për integritet në Policinë e Kosovës;

(i) është hartuar drafti i PSO-së për procedimin e lëndëve dhe kompetencat lëndore të hetimeve;

(j) janë azhurnuar PSO-të për Disiplinë, Komisionin e Brendshëm Disiplinor dhe Komisionin e Ankesave;

(k) janë nënshkruar 12 memorandume të mirëkuptimit;

(l) janë dhënë 2316 komente juridike për verifikimin e të kaluarës kriminale, si dhe

(m) janë kryer 58 interpretime ligjore.

Shëndeti i personelit policor ka qenë në fokus të vazhdueshëm të organizatës. Me qëllim që të identifikohen, të adresohen dhe të parandalohen sëmundjet dhe dukuritë tjera psiko-emocionale në Policinë e Kosovës, gjatë kësaj periudhe:

(a) është ofruar përkrahje shëndetësore ndaj zyrtarëve policorë me risk të lartë ndaj COVID-19;

(b) është ofruar përkrahje psikologjike në menaxhimin e ankthit dhe panikut tek personeli policor shkaktuar nga COVID-19, gjatë së të cilit janë mbajtur 104 seanca psikologjike dhe 35 vlerësime psikologjike;





(c) është hartuar dhe është implementuar plani i veprimit për dezinfektimin e të gjitha objekteve policore në mbarë Kosovën;

(d) janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për të siguruar furnizimin e zyrtarëve policorë me mjete mbrojtëse si: maska mbrojtëse, dorëza dhe dezinfektues;

(e) DShSh ka bërë 365 gjurmime epidemiologjike;

(f) fushata e dhënies vullnetare të gjakut për nevojat e Qendrës Kombëtare për Transfuzionin e Gjakut (QKTGj) në të cilin kanë marrë pjesë 104 punonjës të PK-së;

(g) janë realizuar 22 vizita pjesëtarëve të PK-së nëpër spitale dhe 28 vizita në shtëpinë e tyre.

Gjatë kësaj periudhe, stafi i DShSh-së, ka qenë gjithashtu i angazhuar në mbështetjen e operacioneve policore me autoambulancë në 8 planet operative dhe 6 asistencë.

Policia e Kosovës rëndësi të veçantë i ka kushtuar zhvillimit të modernizimit të teknologjisë informative si dhe zgjerimit dhe mirëmbajtjes të sistemeve të komunikimit dhe menaxhimit të informacionit në përputhje me planin Strategjik të Zhvillimit për 2016-2020.

Në kuadër të Teknologjisë Informative dhe Komunikimit (TIK) janë vazhduar aktivitete të orientuara

në ofrimin e qëndrueshmërisë: (a) Sistemi i Integruar Informativ i PK-së (SIPK); (b) Sistemi Informativ i Menaxhimit të Resurseve të Policisë (PRIMS); (c) Sistemi Integruar i Menaxhimit të Kufijve (BIMS); (d) Sistemit të vëzhgimit përmes kamerave në objektet policore; (e) Projekti 3D-GIS; (f) Implementimi i Sistemit të ri për Linjat Emergjente 192; (g) Përmirësimi i Sistemit Telefonik VoIP;

Policia e Kosovës ka qenë vazhdimisht e përkushtuar në ngritjen dhe forcimin e bashkëpunimit me publikun, mediumet elektronike dhe të shkruara, me qëllim të rritjes së transparencës për veprimet policore. Gjithashtu ka mbështetur dhe ka promovuar disa fushata sensibilizuese në interes të përgjithshëm shoqëror, me theks të veçantë në fushën e sigurisë rrugore, kundër përdorimit të drogave etj.

Gjatë periudhës raportuese në nivel qendror të PK-së janë: (a) lëshuar 54 komunikata me shkrim për media; (b) janë publikuar 182 raporte 24-orësh; (c) janë publikuar 66 aktivitete të ndryshme policore në rrjetet sociale të PK-së; (d) janë dizajnuar dhe publikuar 13 projekte policore; (e) janë publikuar videospote, broshurave vetëdijësuese -Aplikacioni “Lajmëro Policinë” (publikuar në kanal zyrtar të PK-së në youtube, në web faqe të PK-së dhe në rrjetet sociale).

LISTA E SHKURTESAVE

BIMS	Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Kufijve
DHBVK	Drejtoria për Hetime të Brendshme dhe Verifikim të së Kaluarës
DPP	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
DRP	Drejtoria Rajonale e Policisë
DShSh	Drejtoria e Shërbimeve Shëndetësore
GIS	Sistemi Informativ i Gjeografik
GNMI	Grupi Ndër-Institucional për Menaxhimin e Incidenteve
KA	Komisioni i Ankesave
KBD	Komisionin e Brendshëm Disiplinor
KLSP	Këshilli Lokal për Siguri Publike
KKSB	Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi
MIK	Menaxhimi i Integruar i Kufirit
PK	Policia e Kosovës
PRIMS	Sistemi informativ i Menaxhimit të Resurseve të Policisë së Kosovës
PSO	Procedura Standarde të Operimit
QKTGj	Qendrës Kombëtare për Transfuzionin e Gjakut
QS	Qendra Studentore
SIPK	Sistemi i Integruar Informativ i Policisë së Kosovës
UD	Ushtruesi i Detyrës
UO	Urdhër Operativ



POLICIA E KOSOVËS
POLICIJA KOSOVA
KOSOVO POLICE

PROGRAMI RAPORTIMI DIGJITAL APLIKACIONI ‘LAJMËRO POLICINË’

MUNDËSI AL-
TERNATIVE E
KOMUNIKIMIT TË
QYTETARIT ME
POLICINË PËR
LAJMËRIMIN E
RASTEVE

GARANTIM
ANONIMITETI
DHE REAGIM
I SHPEJTË

APLIKACIONI
“LAJMËRO POLICINË”
ËSHTË PLATFORMË
ELEKTRONIKE

MUNDËSI
E DËRGIMIT
TË TEKSTEVE,
FOTOVE
DHE VIDEOVE

RAPORTO
NË 24 ORË



Lajmëro
Policinë

BASHKËPUNIM,
PARTNERITET,
TRANSPARENCË